



57

**REPUBLIKUA E SHQIPËRISË ZYRA
E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Nr. 886/Prot.
/2

Tiranë, me 5. 06. 2002

**L ë n d a: Për ekzekutimin e vendimeve penale dhe trajtimin e të
paraburgosurve.**

**GJITHË PROKURORIVE PRANË
GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË**

Në raportin konfidencial, të muajit prill 2002, të delegacionit të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), janë parashtruar shqetësime të vëzhgimeve gjatë vitit 2001, mbi kushtet, gjendjen dhe trajtimin e të paraburgosurve në Komisaritet e Policisë. Në këtë raport, janë evidentuar shqetësime, që lidhen edhe me ushtrimin e funksioneve të prokurorit, në këtodrejtime:

- Mbipopullimi me të paraburgosur i dhomave të izolimit në Komisaritet e Policisë në disa rrethe mbi kapacitetin e tyre, si: Peshkopi 165%, Burrel 140%, Rrëshen 170%, Tepelenë 130%, Gjirokastër 155%, Sarandë 130%, Pogradec 130%, Gramsh 180%, Laç 150%), Elbasan 125%, Lezhë 150%), Krujë 140%), Durrës 190%, Kukës 160%, Shkodër 170%>, Vlorë 175% dhe Fier 250%.
- Keqtrajtimi, në masën rreth 50% i të paraburgosurve të intervistuar në Komisaritet e Policisë në rrethet Vlorë, Krujë, Lezhë, Pukë, Elbasan, Tepelenë, Gjirokastër, Sarandë, Shkodër dhe Korçë, si në fazën e shoqërimit dhe gjatë marrjes në pyetje, duke i rrahur me grushta, shkelma, shkopinj e deri kondakë armësh, duke specifikuar, një rast dhune të ushtruar që para dy vjetësh, ndaj të paraburgosurin Artan LAZEJ, në Komisaritin e Policisë në Lezhë.

Në këndvështrimin e ushtrimit të funksioneve të prokurorit, për disa probleme të ngritura në këtë raport, të gjithë prokurorët dhe në vecanti ato që merren me ekzekutimin e vendimeve penale, nën kontrollin dhe ndihmën metodike të drejtuesve të Prokurorive pranë Gjykatave të shkallës së parë, duhet të merrin masat e duhura ligjore, që janë të lidhura me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë dhe me trajtimin e të paraburgosurve në Komisaritet e Policisë.

Ju sjellim në vëmendje se: në K. Pr. Penale, nenet 463-469 e vijues, në ligjin Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë", neni 2/1 dhe në ligjin Nr. 8331 datë 21. 04. 1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", nenet 12, 22-23 e vijues, parashikohet ushtrimi i funksionit të prokurori, *per marrjen e masave dhe mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale.*

Theksojmë, gjithashtu, se: ligji "Për ekzekutimin e vendimeve penale" ngarkon, prokurorin pranë gjykatës që ka dhënë vendimin, për të kontrolluar ekzekutimin e vendimeve, përcakton format e kontrollit dhe veprimet e tij, si dhe i jep atij të drejta, për të kërkuar në organet kompetente vënien para përgjegjesisë disiplinore e administrative të personave që kanë kryer ose kanë lejuar shkeljet ligjore të konstatuara, nenet 52-56.

L Mbipopullimi dhe Transferimi i të Dënuarve me Vendim të Formës së Prerë

Në mbipopullimin në paraburgim kanë ndikuar dy aspekte që lidhen edhe me veprimtarinë e prokurorisë, siç janë:

Së pari, mbajtja, në dhomat e paraburgimit të Komisariateve të Policisë në rrethe, e të dënuarve me vendim të formës së prerë dhe mostransferimi në kohë të tyre në institucionet e riedukimit.

Së dyti, zgjedhja, në disa raste, e masës së sigurimit "Arrest në burg" edhe jashtë kushteve dhe kritereve ligjore, që nga kontrollet e ushtruara është evidentuar se kanë përfunduar në dënime siç janë: koha e paraburgimit, pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim, etj.

1. Në ushtrimin e funksionit për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë, tërheqim vëmendjen prokurorëve, për të përmbushur *detyrimet ligjore* dhe për të marrë masat e duhura siç janë:
 - 1.1. të vlerësohet vendi ku i dënuari, me vendim të formës së prerë, do të vuaj dënimin me burgim, nëse mund të jenë burg i sigurisë së lartë ose i sigurisë së zakonshme, neni 22/2 i ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale";
 - 1.2. të përcaktohet në urdhërin e ekzekutimit, institucioni i vuajtjes së dënimit, duke e saktësuar atë që më parë zyrtarishtë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, neni 22/5 i ligjit;
 - 1.3. të nxirren në kohë urdhërat e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë me burgim dhe t'i dërgohen për zbatim Komisarariatit të Policisë ku ndodhet i paraburgosuri, neni 23 i ligjit;
 - 1.4. të ushtrohet kontroll në ekzekutimin e vendimeve, duke siguruar marrjen dijeni për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit, si dhe duke kërkuar informacion, verifikuar dokumentacionin përkatës ose verifikuar periodikishtë, çdo muaj, drejtpërdrejtë vendin/dhomat e

paraburgimit, nëse ka përfunduar ekzekutimi i vendimit, neni 53 i ligjit; 1.5*. 59
 për zvarritjet e evidentuara në transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë nga dhomat e paraburgimit të Komisariateve të Policisë në institucionet/vendet e vuajtjes së dënimit, të lihen afate të përcaktuara, me prioritet transferimin e atyre që kanë kohë më të gjatë qëndrimi, si dhe të ushtrohet kontroll për zbatimin e tyre, neni 55 i ligjit; * të kërkohet vënia para përgjegjesisë disiplinore e administrative të personave që shkelin ligjin në ekzekutimin e vendimeve penale me burgim, duke ia parashtruar këto kërkesa organeve të emërtesës, neni 56 i ligjit.

2. I sjellim, gjithashtu, në vemendje të gjithë prokurorëve, ***për të re&jpektuar kushtet dhe kriteret ligjore në kërkesat për caktimin e mcLsës së sigurimit "Arrest në burg"***, nenet 228-230 të K. Pr. Penale, duke alternuar dhe me zgjedhjen e masave të tjera të përshtatshme të sigurimit personal, vecanarishtë kur është e mundëshme të kërkohet caktimi i masës "Garancia pasurore".

II. Proçeditni Penal në rastet e Keqtrajtimit


Shqetësimet e ngritura në raport, për keqtrajtimin e të shoqëruarve, të arrestuarve në flagrancë ose ndaluarve, ***tërheqin vemendjen e të gjithë prokurorëve që***, mbi bazën e kallzimeve/ankimeve ose dhe kryesishtë kur konstatojnë vetë, ***duhet të fillojnë procedimin penal, për dhunën/keqtrajtimin në dëm të shëndetit të të paraburgosurve, duke venë para përgjegjesisë penale fajtorët.***

Për masat e marra ose pengesat që mund të sjellin institucionet e ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve penale, të njoftohet zyra e Prokurorit të Përgjithshëm.

Kjo qarkore të punohet me të gjithë prokurorët. Drejtuesit e prokurorive të marrin masat e duhura organizative dhe ligjore për të kontrolluar dhe ndihmuar prokurorët, për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë, me synim që shkeljet e raportuara, të lidhura me ushtrimin e funksioneve ligjore të prokurorit, të mos përsëriten në të ardhmen.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Theodhori Sollaku', written in a cursive style.